


Kalendari i aktiviteteve për regjistrimet në programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, pas përfundimit të raundit të dytë

Viti akademik 2026 - 2027

Data	Kandidatët brenda kufijve për herë të parë	
	Aktiviteti	Përgjegjësia
4 Tetor 2026	Përfundon raundi i dytë i regjistrimeve	Sekretaritetë mësimore të fakulteteve
Brenda datës 6 Tetor 2026	Me Vendim Senati përcaktohen programet e studimit që nuk aktivizohen për shkak të mosplotësimit të numrit minimal të studentëve. Ky vendim u komunikohet studentëve të regjistruar në këto programe, afishohet në mjediset e fakulteteve dhe publikohet në web. Vendim i përcillet elektronikisht dhe zyrtarisht MA dhe QSHA.	Fakultetet, Drejtoria e Kurrikulave
7 Tetor 2026	Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e studentëve nga programet e studimit që nuk aktivizohen.	Sekretaritetë mësimore të fakulteteve
Brenda datës 8 Tetor 2026	Shpallen kuotat e paplotësuara për çdo program studimi në faqen e internetit (web) dhe në mjediset e fakulteteve.	Fakultetet
9-13 Tetor 2026	Aplikojnë pranë sekretarive mësimore me dokumentacionin përkatës, kandidatët e çregjistruar për shkak të mosplotësimit të kuotave dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania, që rezultojnë të paregjistruar në asnjë program studimi.	Kandidatët
14 Tetor 2026	Shpallen listat e aplikantëve në web dhe në mjediset e fakulteteve. Një kopje e listës dërgohet në RASH.	Fakultetet
14-17 Tetor 2026	Bëhet renditja e kandidatëve dhe shpallet lista e kandidatëve të renditur.	Fakultetet
19 Tetor 2026	Ankimimi nga kandidatët / Zgjidhja e ankesave	Kandidatët
19 Tetor 2026	Shpallja e listës përfundimtare të kandidatëve të renditur. Njoftimi i kandidatëve për datën dhe orën e paraqitjes për regjistrim.	Fakultetet
20-21 Tetor 2026	Regjistrimi i kandidatëve të paraqitur, sipas planifikimit të bërë nga fakultetet.	Sekretaritetë mësimore të fakulteteve
21 Tetor 2026	Plotësimi i kuotave të lira nga kandidatët e pranishëm.	Sekretaritetë mësimore të fakulteteve

Rektori
Prof. Dr. Akli Fundo





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, ____ . ____ . 2026

**RREGULLORE PËR APLIKIM DHE REGJISTRIM PAS PËRFUNDIMIT TË
RAUNDIT TE DYTË TË KANDIDATËVE NË PROGRAMET E CIKLIT TË
PARË TË STUDIMIT DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË
DYTË TË STUDIMIT, NË UPT**
VITI AKADEMIK 2026-2027

A. PROCEDURA E APLIKIMIT PAS PËRFUNDIMIT TË RAUNDIT TË DYTË

1. Pas përfundimit të raundit të dytë, brenda datës 6 Tetor 2026, me vendim të Senatit Akademik, përcaktohen programet e studimit që nuk aktivizohen në vitin akademik 2026-2027, për shkak të mos plotësimit të numrit minimal të studentëve të regjistruar në to. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të UPT www.upt.edu.al dhe informohen MA, QSHA dhe studentët e regjistruar në këto programe. Sekretaritetë mësimore kryejnë çregjistrimin e këtyre studentëve në datën 7 Tetor 2026.
2. Brenda datës 8 Tetor 2026, fakultetet shpallin kuotat e lira për çdo program studimi në mjediset e fakultetit dhe i publikojnë në faqen zyrtare të UPT, www.upt.edu.al. UPT publikon në web kalendarin e veprimeve për aplikim dhe regjistrim të kandidatëve pas përfundimit të Raundit të dytë të regjistrimeve.
3. Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët e çregjistruar sipas pikës 1 dhe kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania, që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, në ato programe studimi ku ka kuota të pa plotësuar, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, mbi bazën e notës mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, mbi kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga secili fakultet i UPT.
4. Aplikimi i kandidatëve bëhet pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore brenda afateve kohore të përcaktuar në kalendarin e veprimeve. Dokumentacioni për aplikim është si më poshtë vijon:



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

- a. formulari i aplikimit, i cili gjendet pranë sekretarive mësimore (shtojca 1 e kësaj rregulloreje);
 - b. kopje e dokumentit të identifikimit;
 - c. kopje e certifikatës së maturës shtetërore.
5. Në përfundim të procesit të aplikimit, në afatin e përcaktuar në kalendar, sekretaritë mësimore afishojnë listat e kandidatëve që kanë aplikuar sipas programeve të studimit. Këto lista publikohen në websitin e fakulteteve.

B. PROCESI I PËRLLOGARITJES SË PIKËVE, RENDITJES DHE LAJMËRIMI I KANDIDATËVE

1. Brenda afatit të përcaktuar në kalendarin e veprimeve, njësitë kryesore kryejnë përllogaritjen e pikëve për çdo kandidat, në përputhje me kriteret e pranimi të miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 3, datë 30.01.2026 dhe bëhet renditja e tyre në rend zbritës në varësi të pikëve të grumbulluara. Fakultetet shpallin listat e kandidatëve të renditur për çdo program studimi në mjediset e fakultetit dhe në faqen zyrtare të fakultetit. Këto lista përmbajnë vetëm ID e kandidatit dhe pikët e llogaritura, por jo të dhënat personale të tij.
2. Kandidati i renditur ka të drejtë të ankimohet nëse konstaton se pikët nuk i janë llogaritur korektësisht. Procesi i ankimimit dhe kthimit të përgjigjes kryhet brenda afateve të përcaktuar në kalendarin e veprimeve.
3. Fakultetet marrin masat për organizimin e procesit të regjistrimit të kandidatëve të renditur, që janë të pranishëm, brenda kuotave të paplotësuar, për programin përkatës të studimit, duke respektuar rradhën sipas rendit zbritës. Sekretaritë mësimore marrin masat për të lajmëruar të gjithë kandidatët, aplikant në programet e studimit të njësisë kryesore, nëpërmjet telefonit, emailit dhe faqes zyrtare të fakultetit për ditën dhe orën në të cilën do të fillojë procesi i regjistrimit ku të gjithë kandidatët duhet të jenë të pranishëm.



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

C. PROCESI I REGJISTRIMIT

1. Regjistrimi i kandidatëve fitues kryhet pranë sekretarive mësimore të fakulteteve të UPT-së, brenda afateve të përcaktuara në kalendarin e veprimeve sipas planifikimit të bërë nga fakultetet.
2. Kandidatet fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit dhe regjistrimit të kandidatit, sekretaria mesimore bën regjistrimin online në portalin U-Albania. Kandidatët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. kopje e dokumentit të identifikimit;
 - b. kopje të njehsuar me origjinalin (noterizuar) të diplomës së maturës shtetërore/ dëftesës së pjekurisë ose të një diplome studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar nga QSHA, së bashku me certifikatën përkatëse të notave;
 - c. Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.1 të Udhëzimit Nr.12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, e cila plotësohet nga kandidati në prani të punonjësit të sekretarisë mësimore të fakultetit dhe nënshkruhet prej tyre;
 - d. Formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.2 të Udhëzimit Nr.12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”.
3. Sekretaritë mësimore mbajnë regjister të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjister, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të kandidatit kryhet regjistrimi online në Portalin U-Albania. Në fund të procedurës, kandidati dhe punonjësi i sekretarisë mësimore firmosin në dy kopje formularin e printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet kandidatit.
4. Procesi i regjistrimit, pavarësisht numrit të aplikimeve, do të mbyllet në momentin që do të plotësohet numri maksimal i kuotave të pranimit për vitin akademik 2026-2027 (miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 06, datë 12.03.2026) për secilin program studimi.
6. Në datën e fundit të afatit të regjistrimit, nëse në ndonjë program studimi ka ende kuota të paplotësuara, sekretaritë mësimore vazhdojnë regjistrimet me ata kandidatë të listës së



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

renditjes, të cilët nuk ishin të pranishëm në fashën kohore të planifikuar për t'u regjistruar si dhe kandidatë të tjerë të pranishëm, të cilët nuk kishin aplikuar paraprakisht në këtë program studimi, por janë pjesë e portalit U-Albania, nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi dhe plotësojnë kriterin bazë të notës mesatare sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

5. Kandidati, i cili ka kryer regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

D. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Kjo rregullore zbatohet për administrimin e procesit të regjistrimit të kandidatëve në programet e ciklit të parë të studimit dhe programet e integruara të ciklit të dytë të studimit, pas përfundimit të raundit të dytë të regjistrimeve, për vitin akademik 2026-2027.
2. Kjo rregullore shoqërohet me kalendarin e veprimeve dhe me formatin e kërkesës për aplikim, të paraqitur në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
3. Ngarkohen fakultetet dhe sekretariatë mësimore për zbatimin e kësaj rregulloreje.

REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI

SHTOJCA NR.1

Tiranë, më ____/____/2026

KËRKESË

Unë i nënshkruari/a _____ me ID Mature
_____ kërkoj të aplikoj në programin e studimit
_____, në
Fakultetin e _____, me kuotat e
paplotësuara, pas përfundimit të raundit të dytë.

Emër Mbiemër Firmë

Nr. kontakti: _____

Email: _____